



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 1697/Prot.
/2

Tiranë, më 21.08.2024

NJOFTIM PUBLIK

**“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR Z.
GJERGJI FASHO NË ZBATIM TË VENDIMIT 41-2024-1575 (453), DATË 03.05.2024,
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË”**

Adresa: “Viktimat e 7 Shkurtit”, Bashkia Korçë.

Referuar vendimit nr. 41-2023-1530 (70), datë 26.05.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ku znj. Florenca Fasho është përfituese e Ndihmës Juridike Dytësore ka iniciuar procesin gjyqësor me objekt *“Kërkesë për përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin e tarifave dhe shpenzimet gjyqësore”*.

Me Vendimin nr. 41-2024-1575 (453), datë 03.05.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me palë paditëse znj. Florenca Fasho dhe të paditur z. Gjergji Fasho me objekt *“Zgjidhje martesë”* ka vendosur:

1. *Pranimin e padisë;*
2. *Zgjidhjen e martesës midis paditëses Florenca Fasho dhe të paditurit Gjergji Fasho.*
3. *dhe në pikën 10 të dispozitivit të vendimit Shpenzimet gjyqësore në masën 3 000 lekë taksa e padisë dhe 40 000 lekë shpenzime për ekspert u ngarkohen palëve ndërgjygjëse në mënyrë të barabartë pra në masën 50% paditësit dhe 50% të paditurit.*

Në Vendimin përfundimtar gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës së paditur në masën 50%.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka likuaduar për shërbimin e ofruar ekspertin znj. Vasjana Bardhushi me vlerë 40 000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Proçedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit nr. 41-2024-1575 (453), datë 03.05.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, të shumës prej 20.000 lekë, të parapaguara nga ana jonë për shpërblim eksperti (psikologe), ofruar për përfituesin e ndihmës juridike dytësore falas znj. Florenca Fasho.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Gjergji Fasho. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative, kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Bashkinë Korçë, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë. Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Korçë depoziton në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ergys Qirici

